

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirmbajtja e mjeteve motorike ne pronesi te OSSH sha”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT- 178,821,930.00 (njqind e shtatedhjete e tete million e teteqind e njezet e nje mije e nenteqind e tridhjte) Leke pa TVSH.

1,723,087 (nje million e shtateqind e njezet e tre mije e tetedhjete e shtate) Euro pa TVSH

“Mirmbajtja e mjeteve motorike ne pronesi te OSSH sha”, me fond të marrëveshjes kuadër, në vlerën prej: 178,821,930.00 (njqind e shtatedhjete e tete million e teteqind e njezet e nje mije e nenteqind e tridhjte) Leke pa TVSH., si me poshtë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sha.,njesia e prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja pse është marre vendim ne lidhje me parashikimin e mosndarjes ne lote është bere duke patur parasysh faktin se Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Tirane furnizimin me mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi do ta beje per te gjithë Drejtorite Rajonale te OSSH sh.a. Duke u nisur nga kompleksiteti i procedures dhe nga pervoja e meparshme e realizimit te kesaj procedure del ne pah qe niveli i riparimeve kapitale ne nivel vendi nuk është ne parametrat e kerkuara per realizimin me sukses te shërbimit te kerkuar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 të DT;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç**, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojtisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B (ne pronesi ose me kontrate shërbimi), lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Shenim 2.1:

Nëse Operatori Ekonomik, nuk disponon ne pronesi ambient për repartin e bojtisjes por e siguron kete shërbim nepermjet nenkontraktimit, duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 6.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve kundrejt autoritetit kontraktor.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit** . Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes

financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Duke marre ne konsiderate per sa me siper, ku theksohet rendesia e ketij sherbimi, gjithashtu duke marre ne konsiderate vleren e parashikuar te Marveshjes Kuader e cila na kalon ne "Procedure mbi kufirin e larte monetar", afatet e te ciles shtrihen ne kohe, ne menyre qe autoritetit/entit kontraktor te njohe gjendjen financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, per te mundesuar konkurrence gjithepershires, eshte percaktuar dhe vlera e mesiperme.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar nenin 77, pika 3, e Ligjit te Prokurimit Publik, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe parashikimet e legjislacionit te fushes, aktualisht nenit 29, te Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", i ndryshuar, ku percaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij Ligji.

- 2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, ligji nr.10091si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.*

Autoriteti kontraktor e vlereson te nevojshem përcaktimin e nje kriteri te tille bazuar ne faktin qe eshte nje procedure mbi kufirin e larte monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 29, te Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", i ndryshuar, ku percaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij Ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

- 3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) per shlyerjen e taksave vendore per te gjithë vitin 2022 (per NIPT-in kryesor dhe per NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.*

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi Ne lidhje me kerkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit per te paraqitur dokumentacionin e shlyerjes se taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë te vertetojne se ushtrojne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë **personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës**, në përbërje të të cilit të ketë **minimalisht 25 (njetzet e pesë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:**

- 2 (dy) motorrist;
- 7 (shtate) xhenerik;
- 2 (dy) elektroauto
- 2 (dy) bojaxhi;
- 1(nje) pompist
- 1 (nje) saldator
- 2 (dy) gomist

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik të me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- kontratat individuale të punës.
- Diplomë ose Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

Shënim 2.1:

Punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë pre muajin e fundit, Gusht 2023.

Shënim 2.2 : Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë kontratat individuale te punës si dhe diplomat ose certifikatat e kualifikimit prane AK.

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërisë, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj është e nevojshme pasja e një stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, bojaxhi e vertetuar kjo në bazë të kontratave të punës si dhe të deklaratës së plotësuar nga operatori ekonomik me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar në stafin e tij, të paktën:

- (dy) inxhinier mekanik të profilit autotransport (mjete levizese) në detyrën/rolin e drejtuesit teknik
- inxhinier mekatronik diagnostikues difektesh elektrike, elektronike si dhe të sistemit injeksionit të ushqimit në motor për automjetet

Për punonjësin e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesë diplomë përkatëse si dhe kontratën e punës ku të jete percaktuar roli i tij si drejtues teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë me kohë të plotë punë pranë operatorit ekonomik.

Shënim 3.1:

Shënim 3.1:

Punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, Gusht 2023.

të kontratës.

Shënim 3.2: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit ofertuesi fitues duhet të dorëzojë pranë AK diplomën përkatëse dhe kontratën e punës.

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë mekanike, elektrike, etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

4. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- mbi 8 (tetë) ura ngritese për automjetet (me kapacitet jo më pak se 3 Ton)
- 6 (gjashtë) ura ngritese për furgonat (me krah të gjatë) me kapacitet jo më pak se 4ton
- 2 gropa për mjetet e rënda (kamjona, autovinça, fadroma).
- 1 Linjë kontrolli për kamjona (kontroll sistemit frenimit, amortizimit, konvergences)
- 2 linja kontrolli teknik të paisur me ure përkatëse për ngritje dhe kontroll të mjetit
- 2 (dy) pajisje diagnostikuese të difektit në automjet.
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit të automjetit
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit.
- 2 (dy) pajisje për kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) në sistemin e drejtimit.
- 2 pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit.
- 2 pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave të automjetit (ballancim i rrotave).

- 2 pajisje te levizshme (portabile) per ndezje emergjente te mjetit 12v & 24v.
- 1 (nje) paisje bango prove per motorrine dhe dinamo
- 2 (dy) paisje per kontrollin dhe komprimimin e gazit te A/C
- 1 (nje) paisje per rregullimin e ndricimit te automjeteve
- 1 (nje) paisje per kontrollin dhe testimin e gazrave te automjeteve
- 1 (nje) paisje per sistemimin e kontrollit dhe dedektimin te rrjedhjes se systemit te ftohjes te automjetit (Radiatorit dhe Pjeseve perberese te tij)
- Pajisje per kontrollin ne presion te testates dhe cilindrit te motorrit
- Pajisje per pastrimin nga brenda e motorrit me H2
- Pajisje per pastrim te partikularit dhe marmides katalitike (pastrimi DPF)
- 1 (nje) paisje per saldim me oksigjen dhe acitilen
- 1 (nje) paisje per saldim me argon
- 1 (nje) paisje per saldim me elektrik
- 2 (dy) paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit te kompletuara perkatesisht me urat me kater kollona te pershtatshme ne kapacitet per fuoristradat dhe furgonat sipas listes automjeteve referuar specifikimeve ne DT.
- Te kete repart te riparimit karrocise se automjetit (shasise, tapicerise dhe perpunimit te llamarines) si dhe bojatisjes se mjetit te pajisur me :
 - a) 1(nje) furre per lysterje me kapacitet per mjetet fuoristrada dhe furgona
 - b) 1 (nje) furre per lysterje me kapacitet per kamjona, repartin per pergatitjen paraprake
 - c) 1 (nje) pajisje per drejtim shasie te cilat te kene kapacitet ne pershtatje te plote per realizimin e sherbimeve te mjeteve sikurse kerkohet ne specifikimet teknike
 - d) Reparti te jete i kompletuar me pajisjet perkatese (pajisjes poter per drejtim llamarine, puntatrice, aparat saldimi, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi)

Ne lidhje me piken (4) operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- Dokumenta qe vertetojne se keto pajisje i ka ne pronesi ose me qera. (Fatura blerje, dokumente zhdoganimi, kontrata qiraje)
- Fotografi te pajisjeve te mesiperme te cilat kerkohen te jene te montuara ne servis si dhe te paraqiten kataloget/fragmente katalogu perkates te pajisjeve te cilat disponon aktualisht ne servis.

Shënim 4.1:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe insntrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e

automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike e mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin te objektit te prokurimit. Ndërkohe jo vetëm kaq, por specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara ne zërat e riparimit te kërkuara ne Shtojcën 6 (Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit). Përfundimisht, nisur nga faktorët e mësipërm si dhe nga eksperiencia e punës qe kemi ne fushën e autoriparimit, theksojmë që numri i kërkuar me sipër nga ana jone për pajisjet është minimal dhekjo është bërë në përputhje me LPP-ën dhe VKM-ës, për të bërë të mundur kështu pjesëmarrjen e gjerë të OE në realizimin e kësaj procedure prokurimi.

5. Operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht 2 (dy) karrotrec,për transportimin e automjeteve të difektuara, ose në funksion të plotësimit të kriterit të përcaktuar në Shënim 4.1, të pikës 4, të Kapacitetit Teknik,

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shënim 5.1:

Operatorët ekonomikë për mjetin që disponon duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentat që vërtetojnë që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose me huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, nder te cilat mund te ndodh qe ne raste te caktuara duhet të transportojnë nje automjet te difektuar ne ambjentet e servisit qe disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 2 (dy) automjete konketisht karrotrec me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

6. Operatori ekonomik duhet të deklaroj Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me garanci nga prodhuesi dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ne pronesi ose me qera ne perdorim te ambjenteve per ushtrimit te aktivitet te tij (lidhur me riparimin e automjeteve) ne zonat ku ndodhen Drejtorite perkatese te OSSH sha, TIRANE, SHKODER, KORÇË, FIER.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Shënim 2.4.1:

Operatorët ekonomikë për ambjentin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, ambjente ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizimin e prodhuesit/ve ose distributoreve te autorizuar me te cilet bashkepunon per te gjithë artikujt/mallrat objekt i ketij prokurimi. Ne rastin e paraqitjes se Autorizimit te distributoreve, duhe te vertetohet me dokumentat perkatese lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit/ve distributoreve si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i Çertifikuar sipas standarteve perkatesisht :

- certifikate **ISO 9001** per sistemin e menaxhimit te cilesise (te vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar.
- certifikate **ISO14001-2015** per menaxhim mjedisi, (te vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar.
- certifikate **OHSAS - 45001-2018** per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune, (te vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar.

Certifikatat duhet te jene objekt, per aktivitetin qe ushtron lidhur me riparimin e automjeteve. Sa me siper, kerkohet te paraqiten Çertifikatat perkatese.

Te gjitha çertifikatat e mesiperme duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise te pakten ne daten e hapjes se ofertave.

Ne rast se OE jane pjesemarres ne tender si bashkim operatoresh, secili anetar duhet te paraqese ISO ne perputhje me zerat qe do te marre persiper te realizoje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Certifikimi me ISO 9001 eshte i nevojshem, gjithashtu certifikimi ISO 14001/2015 per menaxhim mjedisi eshte i nevojshem per shkak se mjetet qe do te riparohen kane nevojte per bojatisjei cili eshte i demshem kimikisht si per ambientin ashtu edhe per gjallesat.

Certifikimi me ISO 45001 eshte i nevojshem, kjo pasi natyra e ketij sherbimi lidhet direkt me procese te veshtira pune me makineri te renda, te cilat mund te sjellin pasoja per shendetin dhe sigurine e punonjesit

2.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/fragment katalogun e prodhuesit/prodhuesve apo distributorit te autorizuar si dhe skemat origjinale te montimit per pjeset e kembimit qe do te montohen gjate riparimit per mallrat e paraqitura ne Tabelen (Specifikimeve teknike Shtojca 5) bashkelidhur DT.

Tabelat e Artikujve/mallrave te kerkuara te paraqitura nga Autoriteti Kontraktor ne Shtojcen 5(Specifikimet teknike) ne DT duhet te plotesohen rigorozisht nga Ofertuesi per te gjithte zerat e riparimit qe kerkohen ne keto tabela. Te keto tabela nga ofertuesi duhet te plotesohet emri i kompanise prodhuese/ose distributorit te autorizuar, emertimin e katalogut te artikullit/ produktit, nr. i faqes se ketij katalogu si dhe kodin original te pjeses se kembimit qe do te montohet gjate riparimit te mjetit.

Argumentimi Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i

kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizimin e prodhuesit/ve ose distributoreve të autorizuar me të cilët bashkepunon për të gjithë artikujt/mallrat objekt i këtij prokurimi. Në rastin e paraqitjes së Autorizimit të distributoreve, duhet të vertetohet me dokumentat përkatës lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve distributoreve si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njëh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DST. Ky kriter është vendosur në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat e rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **11/09/2023**; Ora: **11:00**; Vendi:
www.app.gov.al, Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sha..